# Fatura e thjeshtuar

# Manuali i përdoruesit

## Hyrje në Portal

Ky dokument paraqet manualin e përdoruesit për aplikacionin SCP në lëshimin e faturës së thjeshtuar.

Për të hyrë në Portal në ambjentin LIVE, autentifikimi bëhet me anë të NIPT dhe password-it për logimin në e-albania, siç tregohet në figurën e mëposhtme.




*Logimi në portal*

## Krijimi i artikujve për shitje

Për lëshimin e faturës së thjeshtuar duhet të shkoni në menynë “Të dhënat e tatimpaguesit” dhe nën-menynë “Lista e produkteve” siç tregohet në figurën e mëposhtme. Në figurën e mëposhtme ilustrohet lista e artikujve që janë të regjistruar.



***Lista e produkteve***

Për të regjistruar artikull të ri duhet të klikoni në butonin “Shto”. Dritarja për regjistrimin e artikullit të ri ilustrohet në figurën e mëposhtme.




*Shto Lista e artikujve*

Plotëso fushat e detyrueshme dhe butoni “Ruaj” aktivizohet. Duke klikuar butonin “Ruaj” artikulli i regjistruar është i ruajtur në listën e artikujve.

## Lëshimi i faturës së thjeshtuar

Për lëshimin e faturës së thjeshtuar kliko në menynë “Faturat” dhe në nënmenynë “Lësho faturë” dhe hapet forma për lëshimin e Faturës së thjeshtuar, siç shfaqet në figurën e mëposhtme.




*Lëshimi i faturës së thjeshtuar*

Për faturën e thjeshtuar duhet të plotësohen fushat e detyrueshme si: Artikulli dhe Mënyra e Pagesës. Për të vendosur artikullin në faturë kliko butonin “Shto Artikull”. Artikulli duhet të zgjidhet nga lista e produkteve, siç është treguar në figurën e mëposhtme.




*Shtimi i artikujve*

Për të shtuar artikullin mjafton ta kërkoni nëpërmjet emrit ose kodit të artikullit.

Në faturë duhet të zgjidhet edhe metoda e pagesës. Kliko në butonin “Shto mënyrën e pagesës” dhe në dropdown shfaqen tre menyrat e pagesës, siç ilustrohet në figurën e mëposhtme.




*Mënyra e pagesës*

Përzgjidh një nga mënyrat e pagesës dhe kliko butonin “Konfirmo”. Pas këtij veprimi aktivizohet butoni “Regjistro faturën”. Kliko butonin “Regjistro faturën” dhe fatura e thjeshtuar ruhet dhe fiskalizohet, siç është treguar në figurën e mëposhtme.

## FATURË - TH

| | |
|---|---|
| Shitësi: | [redacted] |
| Adresa: | Lagjja nr.3, rruga Idriz Alidhima, godina nr.4, kati i pare., Sarande, Albania |
| Numrin Unik i Identifikimit të Tatimpaguesit (NIPT): | [redacted] |

| | |
|---|---|
| Data dhe ora e lëshimit të faturës: | 2021-10-13 17:35:16.0 |
| Numri i Faturës: | 28 |
| Operatori: | ot380hy095 |
| Kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit: | sx843ql005 |
| Lloji i Faturës: | Fatura e parave të gatshme |

| Përshkrimi i Mallit ose Shërbimit | Kodi I artikullit | Njësia e Matjes | Sasia | Çmimi për njësi | Zbritje % | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Dosje | KODI | COPE | 1.0 | 122.00 | | 122.00 |
| | TOTALI PËR T'U PAGUAR (LEK) | | | | | 122.00 |

| | |
|---|---|
| Data dhe ora e kryerjes së furnizimit: | 10/13/21 00:00 |
| Data dhe ora e kryerjes së pagesës: | 10/13/21 12:00 AM |
| Numrin e sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF): | C32A23C24F47BCD1C49FA1A863A83C24 |
| Numrin identifikues të veçantë të faturës (NIVF): | b1ecc5c7-126a-40e0-a6e8-13998ba04079 |

Mënyrën e pagesës:

| Lloj | Sasi (LEK) |
|---|---|
| Kartëmonedha dhe monedha | 122.00 |

*Fatura e thjeshtuar*